

**INSPEKTORATI SHETËROR
I MBIKËQYRJES SË TREGUT**

Nr. 126 Prot. Tiranë, më 16/01 2019

**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE
ELEKTRONIKE DHE POSTARE**

Nr. 67 Prot. Tiranë, më 16/01 2019

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

NDËRMJET

INSPEKTORATIT SHETËROR TË MBIKËQYRJES SË TREGUT

DHE

**AUTORITETIT TË KOMUNIKIMEVE
ELEKTRONIKE DHE POSTARE**

OBJEKTI:

“Për zbatimin ligjor dhe ndërveprimin institucional në kuadër të legjislacionit për pronësinë intelektuale dhe mbrojtjes së konsumatorit”

Tiranë, më 16, Janar, 2019



Ali Kuci



M. J.

Sot, me datë 16, Janar, 2019, lidhet ky Memorandum Bashkëpunimi ndërmjet Palëve:

Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut, me adresë Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Tiranë, përfaqësuar nga Kryeinspektori **znj. Ejana Xhixha**, këtu e në vijim “**Inspektorati**”

dhe

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, me adresë Rruga “Reshit Çollaku”, Tiranë, përfaqësuar nga Kryetari i Këshillit Drejtues **z. Ilir Zela**, këtu e në vijim “**Autoriteti**”.

Duke qenë se Palët:

Duke konsideruar objektiv prioritar rritjen e efijencës së funksionimit të mbikëqyrjes së veprimtarisë tregtare elektronike të operatorëve ekonomikë bazuar në parimet e sigurisë së produktit dhe pronësisë intelektuale, për të garantuar të drejtën e shtetasve shqiptarë për të ushtruar veprimtari të lirë tregtare dhe mbrojtjes së konsumatorit vendas.

Duke vlerësuar rëndësinë e mbikëqyrjes së veprimtarisë tregtare elektronike të operatorëve ekonomikë dhe mediatikë nëpërmjet kontrollit si dhe informimit apo ndërgjegjësisimit të tyre.

Duke konfirmuar vullnetin dhe angazhimin maksimal për të siguruar dhe zbatuar të gjitha mjetet e nevojshme ligjore dhe ekzekutive për forcimin efektiv të kuadrit ligjor dhe institucional të veprimtarisë elektronike tregtare të operatorëve ekonomikë dhe mediatikë.

Duke afirmuar vullnetin e mirë dhe vendosmërinë për të promovuar mirëfunksionimin e institucioneve nëpërmjet bashkëpunimit dhe bashkërendimit ndërmjet tyre në mënyrë konstruktive dhe thelbësore në funksion të realizimit të qëllimit të këtij memorandumi.

Angazhohen për të përmbushur detyrimet që vendos legjislacioni vendas dhe angazhimet e ndërmarra në kuadër të instrumenteve ndërkombëtare.

Në frymën e ndërveprimit institucional të përcjelljes së informacionit dhe përbashkës me sfidat e përbashkëta.

Kanë rënë dakord të lidhin këtë Memorandum Bashkëpunimi, në vijim i quajtur *Memorandum*.

PËRMBAJTJA E MEMORANDUMIT TË BASHKËPUNIMIT

Neni 1 Objekti

Palët zotohen të bashkëpunojnë për të shkëmbyer me njëri-tjetrin informacion sistematik apo dinamik mbi veprimtaritë respektive institucionale. Informacioni i formës së të dhënave deri i problematikave, parashikohet të përcillet nëpërmjet personave të kontaktit dhe takimeve kalendarike.

Neni 2 Baza ligjore

Memorandumi është në përputhje me Ligjin Nr. 35/2016, datë 31/03/2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e lidhura me to”, Ligjin Nr. 9947, datë 07/07/2008, “Për pronësinë industriale”, i ndryshuar, Ligjin Nr. 9918, datë 19/05/2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 36, datë 20/01/2016, “Për krijimin dhe funksionimin e Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut”.

Neni 3 Qëllimi

Memorandumi përbën një angazhim të përbashkët të palëve për zbatimin sa më të plotë dhe në efikasitetin më të lartë në zbatim të Ligjit Nr. 35/2016, datë 31/03/2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e lidhura me to” dhe Ligjin Nr. 9947, datë 07/07/2008, “Për pronësinë industriale”, i ndryshuar.

Neni 4 Roli dhe përgjegjësitë e Palëve

- 4.1 Palët marrin përsipër të angazhohen në zbatimin sa më efektiv në kohë dhe saktësi të këtij Memorandumi.
- 4.2 Palët marrin përsipër të respektojnë parimin e ligjshmërisë, proporcionalitetit, mbrojtjes së interesit publik dhe mbrojtjes së të dhënave personale.
- 4.3 Palët marrin përsipër të mbështesin dhe të realizojnë veprimtaritë e përbashkëta me interes reciprok

Neni 5 **Veprimtaritë e përbashkëta**

5.1 Palët marrin përsipër të kryejnë bashkërisht:

- a. Takime të përbashkëta periodike, 6 (gjashtë) mujore, mbi vlerësimin e ecurisë dhe problematikave të përballura, si dhe koordinimin e veprimtarive vijuese;
- b. Zhvillimin e veprimtarive të përbashkëta për informimin e operatorëve ekonomikë që zhvillojnë veprimtari në hapësirën elektronike, mbi të drejtat dhe detyrimet sipas kuadrit ligjor;
- c. Zhvillimin e fushatave mediatike mbi informimin e operatorëve ekonomikë dhe mbajtësve të të drejtave të autorit mbi të drejtat dhe detyrimet sipas kuadrit ligjor;
- d. Kryerjen e analizave dhe vlerësimeve të përbashkëta me qëllim konkludimin në rekomandime të karakterit ligjor, administrativ dhe vënien e tyre në dispozicion të palëve, të cilat do të vlerësojnë nevojën dhe formën e ndërhyrjeve konkrete bazuar në kompetencat ligjore;
- e. Përcjelljen e informacionit dhe ftesën për pjesëmarrje në veprimtari si workshop, seminare, konferenca, apo të tjera, që bëjnë pjesë në objektet reciproke të institucioneve dhe sjellin vlerë të shtuar në veprimtarinë e tyre.

Neni 6 **Shkëmbimi i informacionit**

- 6.1 Palët marrin përsipër që në mënyrë periodike, çdo 4 (katër) muaj të shkëmbejnë ndërmjet tyre informacion mbi:
- a. Bazën e të dhënave të operatorëve ekonomikë, ku përfshihen të dhënat për NUI, të cilët kryejnë veprimtari të karakterit të medias elektronike;
 - b. Bazën e të dhënave të operatorëve ekonomikë, ku përfshihen të dhënat për NUI, të cilët regjistrojnë domain ose nëndomain al.;
 - c. Bazën e të dhënave të operatorëve ekonomikë, ku përfshihen të dhënat për NUI, të cilët kryejnë veprimtari tregtare elektronike;
 - d. Listën e operatorëve ekonomikë që zhvillojnë veprimtari tregtare elektronike apo medias elektronike, të inspektuar dhe për të cilët është marrë masë në respektim të Ligjit “Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e lidhura me to” dhe Ligjit “Për pronësinë industriale”, në atë hark kohor.
- 6.2 Palët marrin përsipër verifikimin e përbashkët të ankesave të depozituara mbi veprimtarinë dhe shërbimet e operatorëve ekonomikë.
- 6.3 Palët marrin përsipër të përcjellin raporte 6 (gjashtë) mujore të ecurisë së veprimtarive përkatëse dhe problematikave të përballura në këtë periudhë.

Neni 7 Kohëzgjatja

Ky Memorandum lidhet për një periudhë 3 (tre) vjeçare nga dita e nënshkrimit dhe do të jetë efektiv përgjatë këtij afati.

Neni 8 Personat e kontaktit

- 8.1 Secila nga palët përcakton një person kontakti të cilës/it i drejtohen të gjitha komunikimet, si me postë elektronike ashtu dhe me shkresë zyrtare. Në momentin e nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje personat e kontaktit janë si vijon:
- a. Për Inspektoratin Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut caktohet Z. Neritan Frashëri, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Pronësisë Industriale dhe Intelektuale (ISHMT), me adresë elektronike, neritan.frashëri@ishmt.gov.al
 - b. Për Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare Z. Pajtim Melani, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Tregjeve dhe Masave Rregullatore, me adresë elektronike, pajtim.melani@akep.al
- 8.2 Personat e caktuar në pikën 8.1 të këtij neni do të jenë përgjegjës për saktësinë e të dhënave, listave dhe çdo dokument shoqëruar që do të dalë në zbatim të këtij Memorandumi.
- 8.3 Palët angazhohen që përcjellja e informacionit ndërmjet institucioneve të kryhet në afatin e paracaktuar në Kalendarin e përshkruar në Aneksin e Memorandumit.
- 8.4 Në rast të ndryshimit të njërit nga personat e caktuar në pikën numër 8.1 të këtij neni, Pala e cila përfaqësohet prej këtij personi do të njoftojë me shkrim palën tjetër nënshkruese brenda 1 (një) jave kalendarike nga data e ndryshimit, të dhënat e personit të ri të kontaktit.

Neni 9 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Mosmarrëveshjet që mund të lindin mes palëve zgjidhen me frymën e mirëkuptimit dhe me bisedime ndërmjet tyre.

Neni 10
Hyrja në fuqi dhe zbatimi

Ky Memorandum Bashkëpunimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij nga përfaqësuesit e palëve dhe vlefshmëria është tre vjeçare.
Memorandumi përgatitet dhe nënshkruhet në 4 (katër) kopje origjinale, dy prej të cilave depozitohen në Inspektoratin Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut dhe dy të tjera në Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare.

Ky Memorandum Bashkëpunimi u nënshkrua sot, në datë 16 Janar 2019.

Për Inspektoratin Shtetëror të
Mbikëqyrjes së Tregut së


Znj. Ejana Xhixha



KRYEINSPEKTORI ISHMT

Për Autoritetin e Komunikimeve
Elektronike dhe Postare

Z. Ilir Zela



**KRYETARI I KËSHILLIT
DREJTUES TË AKEP**

ANEKS I MEMORANDUMIT

“Kalendari i ndërveprimit institucional”

* Si afat për realizimin e veprimtarive të listuara si më poshtë vijon, paracaktohet java e dytë e secilit muaj duke marrë në konsideratë eventualitetet e paparashikura.

Janar 2019 - Nënshkrimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit ISHMT-AKEP

Prill 2019 - Përcjellja e informacionit ndërmjet institucioneve (1)

Maj 2019 - Takim për analizimin dhe koordinimin e veprimtarive (1)

Gusht 2019 - Përcjellja e informacionit ndërmjet institucioneve (2)

Nëntor 2019 - Takim për analizimin dhe koordinimin e veprimtarive (2)

Dhjetor 2019 - Përcjellja e informacionit ndërmjet institucioneve (3)

Prill 2020 - Përcjellja e informacionit ndërmjet institucioneve (4)

Maj 2020 - Takim për analizimin dhe koordinimin e veprimtarive (3)

Gusht 2020 - Përcjellja e informacionit ndërmjet institucioneve (5)

Nëntor 2020 - Takim për analizimin dhe koordinimin e veprimtarive (4)

Dhjetor 2020 - Përcjellja e informacionit ndërmjet institucioneve (6)

Prill 2021 - Përcjellja e informacionit ndërmjet institucioneve (7)

Maj 2021 - Takim për analizimin dhe koordinimin e veprimtarive (5)

Gusht 2021 - Përcjellja e informacionit ndërmjet institucioneve (8)

Nëntor 2021 - Takim për analizimin dhe koordinimin e veprimtarive (6)